



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE-SKUPSTINA OPSTINE MALISEVO



PRANUAR MË: 17/07/2025
ED ON: 12/78
KOMUNA E MALISHEVËS



Thirrje publike për ekspertë të jashtëm për Komisionin Vlerësues për Projektpropozime të OJQ-ve aplikuese në Thirrjen publike nr.prot.12/75, dt.09.07.2025

Komuna e Malishevës, gjatë vitit 2025, përmes Thirrjes Publike nr. 12/75, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive, konkretisht mbështetjen e projekteve dhe programeve kulturore, rinore dhe sportive.

Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafin 3.2 parasheh që pjesë e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve aplikuese në thirrjen publike

Thirrja Publike është për dy (2) anëtarë, prej tyre- një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm dhe një përfaqësues nga OJQ.

Komuna e Malishevës i fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë në thirrjen publike për ekspertë të jashtëm, për të qenë pjesë e komisionit vlerësues për projektpropozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes Thirrjes Publike nr. 12/75.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët që janë:

- shtetas të Republikës së Kosovës
- të punësuarit apo anëtarët aktiv në OJQ që janë aktive në Republikën e Kosovës;
- ekspertë të pavarur, që kanë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- duhet të kenë diplomë universitare
- të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve
- të mos jenë të emëruar politikë;
- të mos jenë shërbyes civil;
- të mos jenë punëtorë të Administratës Shtetërore;

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- një CV
- një letërmotivimi
- dëshmi për shkollimin;
- dëshmi për përvojën e punës
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër delegimi nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së në të cilën aplikuesi është anëtar apo i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: dkr_s_malisheva@hotmail.com, nga data 17.07.2025 deri më 29.07.2025 dhe me anë të kopjes fizike, në Zyrën për pritjen e palëve në objektin e komunës.

Komisioni Vlerësues i caktuar nga Komuna e Malishevës, pasi të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve, do të formojë regjistrin e ekspertëve të jashtëm dhe të njoftohen të gjithë kandidatët e përzgjedhur.

Malishevë, më 17.07.2025

Drejtori i DKRS-së
Fitim Shala

